



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:240240
Datë: 10.12.2024
Numri i dokumentit: 06575393

C.nr.1793/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Fjolla Osmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.B. nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Qendresa Bytyqi Hoxha, me bazën juridike: kompensim për punë gjatë fundjavës, vlera e kontestit 379.33 euro, jashtë seancës, me 10.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses L.B. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave personale për punën në fundjavë për periudhën kohore 09.10.2021- 14.01.2023, të ia paguaj paditëses për pagën neto shumen prej 328.96 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 36.13 euro, si dhe në emër të tatimit shumen prej 14.24 euro, me kamatë ligjore 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjithë këto ta paguajë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja L.B. në këtë gjykatë me datë 11.06.2024, përmes të autorizuarit të saj Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti, kompensim për punë gjatë fundjavës, vlera e kontestit, 500.00 euro. Në padi ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura në marrëdhënie të rregulltë të punës si mësimdhënëse dhe e njejta ka pagën bazë prej 421.00 euro. Ka shtuar se sipas Vendimit të MASHT, nr.01/B, nr.1860 të dt. 28.09.2021 të punësuarit në arsim janë detyruar nga e paditura për kompensimin e ditëve të mësimit të humbura për shkak të Pandemis Covid-19, përkatësisht për 10 ditë të mësimit. Sipas Vendimit të MASHT, nr. 01/B, nr.2529 të dt. 04.10.2022 të punësuarit në arsim janë detyruar që

tetë ditë të mësimit të pa mbajtura sipas UA 05/2022 për kalendarin e vitit 22/23, të mbahen ditëve të shtune. Padiësja nuk është kompensuar për ditët për të cilat ka punuar gjatë fundjavës. Baza juridike kërkespadiësë është kompensimi shtesë, duke u bazuar në Ligjin e Punës nën 56 par.1 dhe par.2 ashtu që i takon paga shtesë në përqindje të pages bazë, përkatësisht 50% në orë për punën gjatë fundjavës. Andaj ka kërkuar që padia e padiësës të aprovet si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që padiësës në emër të punës së kryer për ditët në fundjavë , gjatë periudhës kohore 09.10.2021 – 14.01.2023 t’ia kompensojë për pagën neto shumen prej 328.96 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 36.13 euro, si dhe në emër të tatimit shumën prej 14.24 euro, të gjitha këto kështu me kamatën ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj Qendresa Bytyqi Hoxha në përgjigjen në padi të dhënë në këtë gjykatë me datë 06.12.2024, ka parashtruar se sipas kontratës së lidhur në mes të padiësës dhe të paditurës në asnjë dispozitë të kontratës nuk ceket se punëtori e gëzon të drejtën për kompensim të pagës shtesë, e të cilën kontratë e kanë nënshkruar dhe janë pajtuar me të gjitha kushtet e kontratës si për detyrat dhe obligimet që kanë. Ka shtuar se padiësi nuk është detyruar nga e paditura Komuna e Gjakovës, mirëpo Komuna e Gjakovës ka pranuar vendimin nga MASHTI për kompensimin e orëve të humbura. Tutje ka deklaruar se padiësi i është referuar nenit 56 të Ligjit të Punës, mirëpo konsiderojmë se kjo dispozitë ligjore nuk i referohet rasteve kur kemi të bëjmë me kompensimin e orëve të humbura në punë, por i referohet punës shtesë krahas punës obligative me orar të plotë të punëmarrësit. Ka parashtruar se Udhëzimi Administrativ nr.07/2021 për kalendarin e vitit shkollor 2021-2022, i lëshuar nga MASHTI, në nenin 9 parasheh se “për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantet, janë të obliguara 160 ditë mësimi 32 javë. Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11 janë të obliguara 175 ditë, 35 javë. Për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët para fillor, janë të obliguara 184 ditë, 37 javë”, ashtu që në rast se nuk do të zbatohet vendimi nr. 01B/2021, për kompensimin e ditëve të mësimit të humbura për shkak të gjendjes me pandeminë Covid-19, nuk do të arrihej respektimi i dispozitave të nenit 9 të UA Nr.07/2021. Tutje ka theksuar se me vendimin e MASHTI Nr.013/453, të datës 04.10.2022 për plotësimin e kalendarit të vitit shkollor 2022-2023 janë përcaktuar qartë ditët e zëvendësimit. Për fund ka theksuar se kërkesëpadija e padiësës është parashkruar konform Ligjit të Punës, e po ashtu nga ana e padiësës nuk janë shterur mjetet administrative para se të dorëzohet padia në gjykatë. Me propozim për gjykatën që të refuzohet kërkesëpadija e padiësës si e pabazuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK- së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesëpadija e padiësës është në tërësi e pabazuar.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, pas pranimit të përgjigjes në padi, duke u nisur nga fakti se, e drejta apo detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është e karakterit absolut, dhe në rrethana të caktuara mund të mos kërkohet mbajtja e një seance publike gjyqësore. Lidhur me këtë aspekt të procedurës, GJEDNJ në rastin Jussila vs.

Finland (Aktgjykimi i datës 23 nëntor 2006, paragrafi 41), ka përcaktuar se, “Detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është absolut. Pra, ekzistojnë rrethana që nuk kërkojnë mbajtjen e një seance gjyqësore publike, dhe atë p.sh., kur nuk ka çështje të besueshmërisë ose fakte të kontestuara mes palëve dhe që determinojnë mbajtjen e një seance gjyqësore, andaj, gjykata mund të vendos në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme lidhur me çështjen në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara.” Gjykata duke marrë parasysh këtë, vendosjen në këtë mënyrë e bazoj duke i nisur nga natyra jo komplekse e çështjes si dhe duke u bazuar në nenin 399 paragrafi 1 të LPK i cili parasheh se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës përkatësisht referuar periudhës së kërkuar me padi nga 09.10.2021-14.01.2023 dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata vlerëson se kërkesa e paditëses për kompensimin e punës në fundjavë rrjedh nga vendimi 28.09.2021, i MASHTI-t, me numër 01B/292, për kompensimin e 18 ditëve të mësimit të humbura për shkak të gjendjes me pandeminë Covid-19, për vitin shkollor 2021-2022, dhe vendimit të SBASHKU-t, të datës 25.08.2022, ku i njëjti kishte vendosur që të futet në grevë para fillimit të vitit shkollor 2022/2023.

Nga shkresat e lëndës dhe përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes paditëses dhe të paditurës nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së punës të datës 01.09.2015, të lidhur në mes paditëses dhe të paditurës.¹

Me dispozitën e nenit 2 pika 2.1 kontratës së punës të paditëses, shprehimisht është përcaktuar se: “Punë kryesi është i obliguar ta realizojë plan programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës”.

MASHT, duke vepruar konform Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ka nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar plan-programin mësimor, konkretisht Udhëzimin Administrativ Nr.07/2021, për Kalendarin e vitit shkollor 2021-2022, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.05/2022, për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023.

Në nenin 1 të këtyre udhëzimeve përcaktohet se “Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave fillore, klasave para fillorë, shkollave të mesme të ulëta, shkollave mesme të larta, institucioneve parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe këshillim”.

Në nenin 9 të UA 07/2021 dhe në nenin 8 të UA 05/2022, në mënyrë të njëjtë është paraparë se “Ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës” Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantet, janë të obliguar 160 ditë mësimi, tridhjetedy (32) javë. Për nxënësit e klasave 9, 10

¹ Kontrata e punës për paditësin Luljeta Baraku.

dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi. 35 javë. Për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët para fillor, janë të obliguara 185 ditë mësimi, 37 javë. Institucionet parashkollore, duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 7 të këtij udhëzimi. Pushimet verore për institucionet parashkollore rregullohen nga institucionet parashkollore në bashkëpunim me DKA-në, gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 15 gusht, ku brenda kësaj periudhe kohore planifikojnë pushimin vjetor në bazë të ligjit të punës. Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është gjatë ditëve të punës, u lejohe të planifikojnë zëvendësimin e mësimin, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim. Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASHTI merr vendim të veçantë”.

Pra nga përkufizimi i kësaj dispozite, del se MASHTI me akt nënligjor përcakton ditët dhe javët e obliguara të mësimin dhe të punës dhe se ndryshimi i këtij Udhëzimi, sipas nenit 8 paragrafi 7 të tij, bëhet me vendim.

Me datë 28.09.2021, MASHTI, me vendimin numër 01B/292, ka marrë vendim për kompensimin e 18 ditëve të mësimin të humbura për shkak të gjendjes me pandeminë Covid-19 për vitin shkollor 2021-2022, duke përcaktuar saktë se ditët e mësimin të zëvendësohen – mbahen të shtunave.

Tutje para fillimit të vitit shkollor 2022/2023, SBASHKU, me datën 25.08.2022 kishte vendos që të futet në grevë, si rrjedhojë e grevës mësimdhënësit nuk i kanë përmbushur detyrimet që dalin nga kontratat e tyre të punës, përkatësisht nuk kanë implementuar Udhëzimin Administrativ nr. 05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023.

Pasi që me datën 03.10.2022 SBASHKU e kishte ndërprerë grevën, MASHT konform nenit 8 par. 7 të UA.nr.05/2022, ka nxjerr vendimin numër 0113/453 të datës 04.10.2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2022-2023, me të cilin vendim ishte përcaktuar që të zëvendësohen ditët e humbura gjatë grevës, ashtu që ishte vendosur që kalendarin mësimor i vitit shkollor 2022/2023 të realizohet edhe në tetë (8) ditë të fundjavës, konkretisht ditën e shtunë të datave 15.10.2022, 22.10.2022, 29.10.2022, 12.11.2022, 26.11.2022, 10.12.2022, 24.12.2022, 14.01.2023. Ndërkaq, po me këtë vendim (pika 9) ishte përcaktuar që mësimdhënësit të cilët nuk kanë marrë pjesë në grevë të zbatojnë kalendarin mësimor të përcaktuar me UA.nr.05/2022 (pra të njëjtit nuk kanë punuar gjatë ditëve të shtunave).

Po ashtu duhet theksuar faktin se pavarësisht se në Ligjin për Grevat, në nenin 18 paragrafi 1 të tij thuhet se “Gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet, që rrjedhin nga Kontrata e Punës”, ndërsa me plotësim ndryshimin e Ligjit për Grevat, neni 7 par. 1, përcakton se “Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas togfjalëshit “Kontrata e Punës “ shtohet fjalia “duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punuar”, pra përcaktohet që pezullohen të drejtat nga kontrata e punës, duke përfshirë edhe pagesën e mësimdhënësve si grevist, andaj është fakt i njohur botërisht që të gjithë mësimdhënësit, duke u përfshirë edhe paditësin, gjatë periudhës së grevës kanë realizuar pagën e rregullt mujore sikurse të kishte punuar.

Nga të lartcekurat, gjykata vërteton se pretendimi i palës paditëse për kompensimin e pagës shtesë për shkak të punës më të gjatë se sa orari i plotë i punës, është në tërësi i pabazuar, për

arsye se orët e punës për paditësen si në kontratën e saj të punës, janë përcaktuara në Udhëzimin Administrativ me nr.07/2021, si dhe Udhëzimin Administrativ nr.05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023 dhe në vendimin me numër 0113/453 të datës 04.10.2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2022-2023, ku për paditësen si mësimdhënëse, sipas kontratës së punës së saj ka pasur të përcaktuar 20 orë mësimi në javë, andaj paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se e njëjta ka punuar më gjatë se sa orari i punës së përcaktuar në UA nr.07/2021 dhe UA nr.05/2022 dhe në kontratën e saj të punës, e si rrjedhojë nuk mund të zbatohet neni 56 i Ligjit të Punës për kompensimin e punës jashtë orarit, sepse paditësi me punën e realizuar gjatë të shtunave të periudhës 09.10.2021 e deri me 14.01.2023, nuk ka punuar orë shtesë, por e njëjta ka zbatuar vetëm detyrimin e saj për të përmbushur orët e saj mësimore, të përcaktuara nga kontrata e punës, e në të cilën kontratë nuk janë të përcaktuara ditët e javës brenda të cilave duhet të përmbushën orët mësimore, por vetëm fondi i orëve mësimore, andaj me vendimi për kompensimin e ditëve të mësimi të humbura për shkak të gjendjes me pandeminë Covid-19 si dhe vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vitit kalendarik të vitit shkollor 2022-2023, nuk nënkuptojnë faktin se paditësi në mënyrë burimore ka punuar orë më tepër se sa ato të përcaktuara në UA nr.07/2021 dhe UA nr.05/2022, si dhe fakti se ajo ka punuar ditëve të shtuna, në asnjë formë nuk ka cenuar të drejtat e saj të njohura me ligjet në fuqi, veçse ka kompensuar orët e humbura për arsyet e dhëna si me lartë. Andaj, gjykata ka vlerësuar se këto dispozita të këtyre akteve normative vlejné edhe për punën në kohën e pushimit pranveror, veror dhe dimëror.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, mirëpo një pretendim i tillë nuk gjeti mbështetje marrë parasysh dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës, e cila dispozitë ka paraparë realizimin e të drejtave të te punësuarve në afatin prej 3 viteve, andaj marrë parasysh periudhën e kërkuar përkatësisht 09.10.2021 deri me datë 14.01.2023, si dhe paraqitjen e padisë, rezulton se pjesa e kërkesëpadisë se paditëses nuk është e përfshirë në afatin e parashkrimit, ngase nga koha kur ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin objekt kontesti, e deri në paraqitjen e padisë nuk ka kaluar afati 3 vjeçar.

Janë vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës.

Andaj, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim, pasi që gjykata ka konstatuar se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 që përcakton se “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”, e lidhur me nenin 463.1 të të njëjtit ligj që përcakton se “Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin, 143.1 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1793/24, me 10.12.2024

GJYQTARJA:

Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.